

VENDIM
Nr.5, datë 2.2.2015

PËRFILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË ROBERTO OIL SHA NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8 pika 2, germa "a"; 9; 13 pika 1 germa "ç"; 45, pikat 3 dhe 4 dhe 48, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa "P"; 5, pika 1, germa "P"8; 10, pika 1 dhe 3, të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, neni 18, pika 1, germa "a", të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.2.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria Roberto Oil sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Roberto Oil sh.a." plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit, i paplotësuar

- Neni 9, pika 2. Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është i plotësuar pjesërisht. Mungon vërtetimi nga prokuroria, që drejtuesi i shoqërisë nuk është në proces penal dhe struktura e funksionimit administrativ të shoqërisë.

- Neni 9, pika 3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar tërësisht.

- Neni 9, pika 4/9, germa "a". Mungon sasia e energjisë elektrike që parashikohet për furnizimin e klientëve të kualifikuar për pesë vitet e ardhshme

- Neni 9, pika 4/9, germa "b". Mungon niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët e kualifikuar.

- Neni 9, pika 4/9, germa "c". Mungon deklarimi i kapitalit financiar të vënë në dispozicion për realizimin e këtij aktiviteti.

- Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Roberto Oil sh.a.", për licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti